



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"

REKTORETI I UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" GJILAN
KEDS - S.H.A.

№ 252 dt 16.06.2016



Programi për Leadership
Kompania Kosovare për Distribuim
dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a

UNIVERSITETI GJILANIT UNIVERSITY OF GJILAN			
№	44 06.2016		
Org	Numër	Shitja	Vite
	01/453		

Ref. Nr: 01/453

Datë: 14 1001 2016

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 28 paragrafit 1.11 të Statutit të universitetit, lidh:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI NDËRMJET

UNIVERSITETIT TË GJILANIT "KADRI ZEKA"

DHE

KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.

Duke pasur parasysh që Programi i Trajnimit Praktik në KEDS ka për qëllim ofrimin e praktikës profesionale në ndërmarrje për studentë dhe do të ofroj mundësi për të mësuar për bazat e sistemit elektroenergjetik, përgjegjësinë sociale dhe edukimin për energjetikë, si dhe për të kuptuar rolin e ndërmjetësimit energjetik dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Me qëllim që studentëve të ju ofrohen mundësi në përmbushjen e kompetencave profesionale përmes pjesëmarrjes dhe zbatimit të projekteve konkrete në një ambient real pune me karakter njohës dhe hulumtues në KEDS.

Duke pasur parasysh që Universiteti "Kadri Zeka" ka shprehur gatishmëri dhe interesim për aftësimin e studentëve në aspektin praktik, duke identifikuar studentët më të dalluar në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave me qëllim të avancimit të programit të tyre;

Universiteti dhe Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (këtu e më tutje të referuara si "Palë"), me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ngritjes së njohurive dhe shkathhtësive profesionale të studentëve, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë Marrëveshje palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim, me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të shkathhtësive profesionale praktike të studentëve, përmes dhe sipas kushteve të programit të trajnimit praktik në KEDS, përkatësisht "Programi për Leadership", i cili është i bashkangjitur dhe është pjesë e këtij Memorandumi.

2. Ngritja dhe zhvillimi i njohurive dhe shkathtësive praktike do të realizohet përmes ofrimit të Moduleve të trajnimit nga Lëmi i Menaxhimit dhe zgjidhjes së problemeve profesionale të paraqitura në rrjetin e shpërndarjes dhe distribuimit të energjisë elektrike, si në vijim:
 - 2.1. Parimet themelore të kompanisë, energjetika, roli dhe rëndësia për ekonominë;
 - 2.2. Menaxhimi dhe parimet bazë të udhëheqjes;
 - 2.3. Teknologjia dhe roli i zbatimit në proceset e punës;
 - 2.4. Konceptet kryesore për zhvillimin energjetik, menaxhimi mjedisor dhe globalizimi;
 - 2.5. Programet teknike, me theks të veçantë në lëmin e energjetikës;
 - 2.6. Detyra specifike dhe projekte që i zhvillojnë aftësitë profesionale dhe personale, si individë dhe si pjesëtarë të ekipit.

Neni 2 Qëllimi i programit

1. Programi për Leadershipit në KEDS ka për qëllim ofrimin e praktikës profesionale për studentë me qëllim të arritjes së kompetencave profesionale të parapara në kurrikulen kombëtare. Programi do të ofrojë mundësi për të mësuar për bazat e sistemit elektroenergjetik, përgjegjësinë sociale dhe edukimin për energjetikë, si dhe për të kuptuar qartë rolin e ndërmjetësimit energjetik dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik të një vendi.
2. Studentët do të kenë mundësi në përmbushjen e kompetencave profesionale përmes pjesëmarrjes dhe zbatimit të projekteve konkrete në një ambient real pune me karakter njohës dhe hulumtues, të zhvilluar në KEDS.
3. Përfaqësuesit e UKZ-së kanë shprehur gatishmëri dhe interesim për aftësimin e studentëve në aspektin praktik, duke identifikuar studentët më të dalluar në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave me qëllim të avancimit të programit të tyre;
4. Palët, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ngritjes së njohurive (shkathtësive profesionale), kanë parë interesin e përbashkët për të lidhur këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit.

Neni 3 Obligimet e KEDS-it

1. Obligimet e KEDS janë:
 - 1.1. Identifikimi i mentorëve që do t'i monitorojnë studentët gjatë implementimit të programit të trajnimit;
 - 1.2. Krijimi i kushteve të punës për studentët të cilët janë pjesë e këtij programi;
 - 1.3. Përgatitja dhe organizimi i programeve të trajnimit;
 - 1.4. Dizajnimi i aktiviteteve javore për zbatimin e projektit;
 - 1.5. Sigurimi i të gjitha materialeve të nevojshme për trajnim;
 - 1.6. Të sigurojë që përfaqësuesit e fakulteteve mund të vëzhgojnë nga afër procesin dhe të arriturat e studentëve;

- 1.7. Të organizojë dhe marrë pjesë në takime të rregullta me qëllim të vlerësimit të rezultateve të projektit;
- 1.8. Të përkrahë studentët në përgatitjen e provimit profesional duke u bazuar në shembuj dhe ekspertizë të punës praktike;
- 1.9. Bazuar në formatin e përgatitur nga fakulteti, kompania në fund të praktikës profesionale do të bëjë vlerësimin e studentëve;
- 1.10. KEDS mbulon të gjitha shpenzimet për ofrimin e trajnimit në kuadër të Programit të Liderimit të KEDS-it.

Neni 4 Obligimet e Fakulteteve

1. Obligimet e fakulteteve janë:
 - 1.1. Përpilimi i listës së studentëve që do të jenë pjesë e projektit dhe përzgjedhja e tyre në bashkëpunim me Programin e Liderimit KEDS;
 - 1.2. Mbështetja me personel akademik për realizimin e programeve të trajnimit;
 - 1.3. T'i sigurojë dy anëtarë të komisionit nga fusha përkatëse për mbrojtjen publike të prezantimit të punës praktike;
 - 1.4. Pas përfundimit të suksesshëm të programit të trajnimit dhe punës praktike, si dhe prezantimit të suksesshëm para komisionit përkatës, fakulteti do ta vlerësojë me ECTS kredi sipas programeve të studimeve të njësisë akademike;
 - 1.5. Fakulteti ka obligim që të organizojë prezantim publik të punës praktike para komisionit, në përbërjen e të cilit marrin pjesë tre anëtarë: koordinatori nga fakulteti, mentori nga ana e kompanisë ku është kryer puna praktike dhe një anëtar i komisionit nga fusha relevante që e cakton fakulteti;
 - 1.6. Fakulteti e ka për obligim që secili student të pajiset me një flete udhëzim për të qenë pjesë e projektit.

Neni 5 Pajtueshmëria e KEDS dhe UKZ-së

1. KEDS dhe UKZ pajtohen me të gjitha pikat e Memorandumit.
2. Përkritazi me detyrat dhe përgjegjësitë e mësipërme të këtij Memorandumi secila palë nënshkruese duhet t'i bartë përgjegjësitë në fushën e detyrimeve dhe përgjegjësisë të pranuar me këtë Memorandum, të cilat janë në harmoni me Ligjin e aplikueshëm të Punës.
3. Palët nënshkruese do të mbajnë kontakte të përhershme për zbatimin e këtij Memorandumi;

3.1. Do të shkëmbejnë përvoja me interes të përbashkët do të njoftojnë njëra tjetrën me çdo kërkesë, vërejtje, sugjerim a propozim që ka të bëjë me realizimin e projektit sipas kushteve të këtij Memorandumi.

Neni 6
Dispozitat tjera

Nëse palët vlerësojnë se marrëveshja duhet ndryshohet apo plotësohet, secila palë mund të propozojë projekt - amendamente, dhe me pëlqim të dyanshëm amendamentet e propozuara duhet te miratohen.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kontestet eventuale lidhur me marrëveshjen do të zgjidhen përmes bisedimeve ndërmjet palëve, po qe se kjo nuk është e arritshme çështja do të shtrohet në gjykatën kompetente.

Neni 8
Numri i kopjeve identike të marrëveshjes

Marrëveshja nënshkruhet në katër (4) kopje identike, nga dy (2) kopje për secilën palë të marrëveshjes, të cilat kanë forcë të njëjtë juridike.


Neni 9
Hyrja në fuqi


Ky Memorandum i Mirëkuptimit hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e udhëheqësve (drejtuesve) të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan dhe të KEDS-it, përkatësisht përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

Marrëveshja e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit do të nënshkruhet në Prishtinë me datë:
16/06/2016

Për
Universitetin "Kadri Zeka"

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi


Rektor i UKZ.-së



Për
KEDS-in

George Karagutoff


Drejtor i Përgjithshëm

